



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 48, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe pikës 12 të Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistemore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17), guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

UDHËZIM

për ndryshimin e Udhëzimit për zbatimin e Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistemore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/23)

1. Në Udhëzimin për zbatimin e Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistemore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/17 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/20 dhe 112/21), në pikën 6, paragrafi 2, nënparagrafët 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"- vlera maksimale e nënkategorisë së pestë është shuma e vlerësimit përmbledhës të bankës me rëndësinë më të lartë sistemore deri më 31 dhjetor 2022 (2.547 pikë bazë) dhe devijimit standard nga vlerësimet përmbledhëse të bankave të identifikuara me rëndësi sistemore (706 pikë bazë);

intervalët për secilën nënkategori me rëndësi sistemore përcaktohen duke pjesëtuar me 4 dallimin ndërmjet vlerës maksimale të paragrafit 2 të këtij paragrafi (3.253 pikë bazë) dhe vlerës minimale të paragrafit 1 të këtij paragrafi (350 pikë bazë) dhe kjo vlerë (726 pikë bazë) i shtohet kufirit të poshtëm të çdo nënkategorie me rëndësi sistemore."

Paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

"Këto përllogaritje kanë të bëjnë me të dhënat e 31 dhjetorit 2022, me ç'rast kufijtë e nënkategorive me rëndësi sistemore janë fikse më së voni deri në llogaritjen me gjendjen më 31 dhjetor 2024."

2. Shtojca nr. 2 Shtresa mbrojtëse e kapitalit për çdo nënkategori me rëndësi sistemore, zëvendësohet me shtojcë të re nr. 2 që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

U nr. 02-10519/1
20 mars 2023
Shkup

Guvernatorja
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

Shtojcë nr. 2**Shtresa mbrojtëse e kapitalit për çdo nënkategori me rëndësi sistemore**

Nënkategori me rëndësi sistemore	Interval	Shtresë mbrojtëse e kapitalit për bankat me rëndësi sistemore
5	mbi 3.253	3,5%
4	mbi 2.527 deri 3.253	2,5%
3	mbi 1.802 deri 2.527	2,0%
2	mbi 1.076 deri 1.802	1,5%
1	350 deri 1.076	1,0%